



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____ Nr. Prot. _____
Dep. DPK Br Prot. 03-03/1135/18
Broj stranica _____ Datum _____
Nr. pages 03 Date 11-04-2018

DATË/A:	11.04.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-1091/18
PËR/ZA/TO:	z. Artan FEJZA Menaxher i zyrës së Prokurimit në Ministria e Shëndetësisë
CC:	z. Naim Bardiqi Sekretar i Përgjithshëm në Ministria e Shëndetësisë
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin me titull: “Furnizimi me Storage, Server dhe San Swich” me nr. të prokurimit 206/18/1760/121, nr. të brendshëm 206/18/027/121.

I nderuar z. Fejza,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: **“Furnizimi me Storage, Server dhe San Swich”** me nr. të prokurimit 206/18/1760/121, nr. të brendshëm 206/18/027/121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: **“Furnizimi me Storage, Server dhe San Swich”** me nr. të prokurimit 206/18/1760/121, nr. të brendshëm 206/18/027/121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik

nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

A r s y e t i m i

Agjencia kundër Korrupsionit, me datë 06 prill 2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: AKK-03-03-1091/18, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizimi me Storage, Server dhe San Swich”** me nr. të prokurimit 206/18/1760/121, nr. të brendshëm 206/18/027/121, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Ministria e Shëndetësisë.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma E-Prokurimi, ka analizuar njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të hapur, kontratë publike, llojit furnizim, me vlerë të mesme të parashikuar 124,000.00€. Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka vërejtur që njoftimin për kontratë në nenin III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar: *“Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses furnizime të ngjashme (furnizim me Storage të nivelit të njejt, midrange ose enterprise) minimum tri kontrata gjatë tri viteve të fundit deri ne njoftimin për kontratë në vlerë prej 180,000.00€”,* kërkesë kjo për të cilën Agjencia konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht me nenin 69.

Sipas Legjislacioni në fuqi për Prokurim Publik më saktësisht në nenin 69 paragrafi 2.1 parashihet se “Për të vërtetuar aftësitë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik, autoriteti kontraktues mundet të kërkojë listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkënenshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë.

Agjencia kundër Korrupsionit, konsideron se këtë rast do të duhej të kërkohej lista e kontratave bashkangjitura referencat për përfundimin e kontratave në vlerë totale të gjithë referencave të furnizimeve të ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë, e jo si në rastin konkret ku janë kërkuara minimum 3 (tri) kontrata në vlerë prej 180,000.00€.

Konsiderojmë se veprimet e tilla si në rastin konkret e kufizojnë konkurrencë e lirë dhe diskriminojnë operatorët ekonomik të cilët mund të ofrojnë furnizime të tilla të kënaqshme.

Agjenci kundër Korrupsionit, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo-diskriminimi, nenin 27 Dosja e tenderit si dhe nenin 69 Aftësitë teknike

dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 26.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Agjencia pas trajtimit të dokumentacionit për tenderin me titull: **“Furnizimi me Storage, Server dhe San Swich”** me nr. të prokurimit 206/18/1760/121, nr. të brendshëm 206/18/027/121, ju njofton me të gjeturat e këtij aktiviteti të prokurimit dhe rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

2 AUGUSTO 2018